

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë publikon këtë:

K O N K U R S

Pozita: Kontabilist Financiar

I përgjigjet: Zyrtarët të Lartë Financiar

Ekzekutues: 1 (Një).

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (3 mujore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen regjistrimin dhe procesimin e të gjitha faturave hyrëse dhe dalëse të kompanisë, furnizuesve.
- Kryen përshkrimin dhe likuidimin e faturave të kompanisë në kohë;
- Kryen regjistrimet e pagesave;
- Përpilon pasqyrat e blerësve dhe furnizuesve në afatet e caktuara;
- Përditëson dhe harmonizon librat kontabël me blerës dhe furnizues në afatet e caktuara ligjore;
- Shkruan dhe regjistron saktë, përgadit dhe mban dokumentet e regjistrimit e kontabilitetit;
- Konsolidon llogaritë në kohën e duhur;
- Përditëson në kohë të dhënat ditore të transaksioneve financiare në bazën e të dhënave;
- Siguron ndihmën dhe mbështetjen për personelin në sektorin përkatës;
- Hulumtimon, gjurmon dhe zgjidh problemet e mundshme dhe mospërputhjet kontabël ose ato të dokumentacionit;
- Informon menaxhmentin dhe harton raporte / përmbledhje mbi fushat e aktivitetit;
- Zbaton në përputhje të plote standardet, procedurat dhe ligjet e aplikueshme;

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- ❖ Diplomë universitare Bachelor në Ekonomi drejtimi Financa dhe Kontabilitet;
- ❖ Punëtor i aftësuar ose i trajnuar në fushën e Financave dhe Kontabilitetit;
- ❖ Demonstron aftësi në të kuptuarit dhe aplikuarit të parimeve bazë të kontabilitetit;
- ❖ Dëshmi për përvojën e punës në fushën e financave dhe kontabilitetit të dëshmuara nga referencat e prezentuara;
- ❖ 3 vjet përvojë pune të dëshmuara nga ATK-ja;
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Vërtetim nga gjykata, që kandidati-ja nuk është nën hetim;
- ❖ Letër motivimin;

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr "Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web-faqen "Hidrodrini" Sh. A. www.hidrodrini.com.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU "Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. "Lekë Dukagjini" nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës). Shpallja do të jetë e hapur 15 Ditë (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web-faqen www.hidrodrini.com.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e derguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen, KRU "Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.